



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	148
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	07.06.2017
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/148/2017

Datë: 01/06/2017

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e tretë të përbërjes së parë, të mbajtur më 01 qershor 2017, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja Nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Aleksandër Lumezi

A. Lumezi
Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë
Udhëheqësit të PTF-së
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë /Akademija Pravde /Academy of Justice

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, dhe neni 19 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur me dt. 01.06.2017,

Miraton:

RREGULLORE NR. 03/2017
PËR TRAJNIMIN FILLESTAR

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton organizimin e trajnimit fillestar, të drejtat dhe detyrimet e përfituesve, raportin mes trajnuesve dhe mentorëve me Akademinë e Drejtësisë (në tekstin e mëtejme Akademia), si dhe kriteret për përfundim në mënyre adekuate të trajnimit fillestar.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet nga Akademia për qëllimet e përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 3
Përkufizimet

1. **“Përfituese i Programit të Trajnimit Fillestar”** nënkupton gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të sapoemëruar të cilët kanë obligim të ndjekin trajnimin fillestar siç është përcaktuar me Ligjin për Gjykata dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit.
2. **“Trajnuesi”** nënkupton ekspertin siç është përcaktuar në Rregulloren për Trajnues dhe Mentor, i angazhuar për të zbatuar programin trajnues.

3. **“Mentori”** nënkupton gjyqtarin dhe prokurorin e shtetit siç është përcaktuar në Rregulloren për Trajnues dhe Mentor, i angazhuar për të mbështetur gjyqtarin apo prokurorin gjatë trajnimit praktik.
4. **“Trajnimi fillestar”** nënkupton trajnimin siç është përcaktuar me Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Gjykatat dhe Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit.
5. **“Kompetenca”** nënkupton tërësinë e njohurive profesionale dhe shkathtësive praktike me qëllim të realizimit të detyrave të punës siç është përcaktuar nga Akademia.
6. **“Programi i Trajnimit Fillestar”** nënkupton njësinë organizative në kuadër të Akademisë, përgjegjëse për zbatimin e trajnimit fillestar.

Neni 4

Organizimi i trajnimit fillestar

1. Përgjegjës për organizimin e trajnimit fillestar është Akademia
2. Akademia në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJK) dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK), koordinojnë aktivitetet për organizimin e trajnimit fillestar për aftësimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapoemëruar.

Neni 5

Programi trajnues

1. Përmbajtja e programit trajnues miratohet nga Këshilli Drejtues i Akademisë sipas kohëzgjatjes të përcaktuar me legjislacionin në fuqi.
2. Programi trajnues konsiston në zhvillimin e këtyre kompetencave:
 - 2.1 Aftësitë dhe shkathtësitë profesionale dhe praktike,
 - 2.2 Integritetin personal dhe sjelljet etike,
 - 2.3 Zbatimi i standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut,
 - 2.4 Arsyetimin e vendimeve gjyqësore dhe aftësinë komunikuese,
3. Programin e trajnimit Akademia e harton në bashkëpunim dhe koordinim me KGJK, KPK, Gjykatën Supreme të Kosovës dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Neni 6

Struktura dhe kohëzgjatja e trajnimit

1. Programi trajnues realizohet përmes trajnimit teorik dhe praktik për periudhën 12 muaj.
2. Trajnimi teorik realizohet dy (2) ditë në javë, përmes moduleve trajnuese të hartuara nga trajnuesit e angazhuar nga Akademia.
3. Trajnimi praktik mbahet tri (3) ditë në javë dhe realizohet në gjykatat dhe prokurorit e nivelit themelor ku janë të emëruar gjyqtarët dhe prokurorët, me mbështetjen e gjyqtarëve përkatësisht prokurorëve të shtetit - mentorët.
4. Gjyqtarët e caktuar në departamente dhe divizione, trajnimin praktik e ndjekin nën mentorimin e gjyqtarit që punon në atë departament apo divizion.
5. Programi praktik realizohet duke u mbështetur në programin e miratuar nga Këshilli Drejtues dhe Doracakun për zbatimin praktik të trajnimit.
6. Përjashtimisht nga paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni, me qëllim të përmbushjes së programit trajnues siç përcaktohet nga Këshilli Drejtues, Drejtori i Akademisë mund të ndryshoj numrin e ditëve të trajnimit në zbatim të kurrikulës së përcaktuar.
7. Akademia, krijon mekanizmat e nevojshëm për të përcjellë zbatimin e programit trajnues nga ana e trajnuesve dhe mentorëve.

Neni 7

Fillimi i Programit Trajnues

1. Akademia bën të gjitha përgatitjet për fillimin e trajnimit fillestar në javën e parë të muajit tetor të vitit kalendarik;
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, trajnimi fillestar mund të filloj më së largu 3 muaj pas kërkesës së KGJK-së ose KPK-së;
3. Akademia mund të hyj në marrëveshje bashkëpunimi me KGJK dhe KPK për zbatimin e trajnimit fillestar.

Neni 8

Orari trajnues

1. Trajnimi organizohet gjatë ditëve të punës sipas orarit zyrtar të punës;
2. Përjashtimisht, me qëllim të realizimit në tërësi të programit trajnues, trajnimi mund të

organizohet edhe ditëve të vikendit apo me orar të zgjatur nga orari zyrtar sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 9

Vijueshmëria

1. Vijueshmëria e rregullt e trajnimit është obligative për pjesëmarrësit e trajnimit fillestar;
2. Akademia do të zbatoj kriteret dhe rregullat e përcaktuara nga KGJK dhe KPK lidhur me shfrytëzimin e pushimeve siç është e përcaktuar me ligj.

Neni 10

Mbarëvajtja e trajnimit fillestar

1. Gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të sapoemëruar janë të obliguar:
 - 1.1 Të njoftojnë me shkrim (email apo formë tjetër), për mungesën në trajnim Kryetarin e Gjykatës, Kryeprokurorin e prokurorisë përkatëse, Akademinë dhe mentorin;
 - 1.2 Të respektojnë ligjet, rregulloret përkatëse lidhur me trajnimin fillestar dhe rregullat për etikën profesionale, rregullat dhe qetësinë në mjediset e brendshme të Akademisë, dhe në institucionet tjera jo gjyqësore të cilat janë pjesë e programit praktik;
 - 1.3 Të mirëmbajnë dhe mirë administrojnë materialet dhe pajisjet, që u vihen në dispozicion gjatë kohës së ndjekjes së trajnimit fillestar;
 - 1.4 Respektojnë rregullat për veshjen që do të përdorin gjatë periudhës së trajnimit fillestar;
 - 1.5 Respektojnë trajnuesit, mentorët dhe stafin e Akademisë gjatë kohës së programit trajnues;
 - 1.6 Të mos përdorin telefonin apo mjete tjera të teknologjisë gjatë kohës së zhvillimit të trajnimeve në Akademi;
 - 1.7 Të nënshkruhen në listën e regjistrimit me rastin e hyrjeve dhe daljeve qoftë në objektin e Akademisë dhe gjykatës/prokurorisë përkatëse;
2. Mungesat e përsëritura dhe të pajustificuara do të jenë bazë për fillimin e procedurave të përcaktuara me aktet normative dhe Kodin e Etikës profesionale.
3. Akademia përgatitë raporte në baza javore lidhur me vijueshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit gjatë trajnimit, dhe i njofton KGJK dhe KPK.

Neni 11

Kriteret për përfundim adekuat të trajnimit

1. Për të vlerësuar përmbushjen e trajnimit në mënyrë adekuate të përfituesve në trajnimin fillestar, Akademia bazohet në kriteret, si në vijim:
 - 1.1. Raportet e vijueshmërisë (aneksi 1);
 - 1.2. Raportet e trajnuesve për rezultatet e vlerësimit për përfundim të moduleve trajnuese

(aneksi 2);

1.3. Raportet dhe vlerësimi i mentorëve (aneksi 3);

1.4. Punimet hulumtuese (aneksi 4);

2. Rezultatet e trajnimit fillestar të përcaktuara në paragrafin 1 përfshihen në raportin përfundimtar të Akademisë për secilin përfitues të trajnimit për të cilin bëhet vlerësimi për përmbushjen e programit në mënyrë adekuate dhe i njëjti i dërgohet KGJK dhe KPK për vlerësim të mëtejshëm;
3. Format e vlerësimit janë pjesë e kësaj rregulloreje në formë aneksi.

Neni 12

Trajnimet shtesë

1. Bazuar në raportin përfundimtar vlerësues për përmbushjen e trajnimit, KGJK dhe KPK mund të kërkojnë trajnime shtesë për gjyqtarët apo prokurorët e shtetit të cilët nuk kanë treguar performancë të kënaqshme në përfundim të trajnimit.
2. Kërkesa për trajnimin shtesë përmban kohëzgjatjen dhe përmbajtjen e trajnimit që duhet të ndjek gjyqtari apo prokurori i shtetit i sapoemëruar.
3. Pas përfundimit të trajnimit sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, Akademia do të përgatis raport përfundimtar për gjyqtarin apo prokurorin e shtetit që ka ndjek këtë trajnim shtesë.
4. Akademia fillon trajnimin fillestar shtesë brenda një afati të arsyeshëm por jo më larg se 3 muaj nga dita kur bëhet kërkesa.

Neni 13

Të drejtat dhe detyrimet e përfituesve

1. Gjyqtari apo prokurori i shtetit që nuk e fillon apo e ndërprejnë trajnimin fillestar me arsye, mund të ndjek trajnimin në gjeneratën e ardhshme sipas kërkesës së KGJK-së apo KPK-së.
2. Gjatë ndjekjes së trajnimit fillestar gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe rregullave të etikës si dhe kësaj rregullore.

Neni 14

Rregullat disiplinore

1. Për shkeljet disiplinore dhe rregullat tjera të trajnimit, gjyqtarët apo prokurorët e shtetit në trajnim do t'i nënshtrohen rregullave dhe procedurave që zhvillohen nga KGJK apo KPK.

2. Akademia e njofton KGJK dhe KPK lidhur me sjelljen e gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë trajnimit, të cilat mund të përbëjnë shkelje të rregullave dhe etikës.

Neni 15

Vlerësimi i përmbushjes së trajnimit

1. Vlerësimi për përfituesit e trajnimit fillestar organizohet me shkrim dhe do të bëhet në përputhje me kompetencat që do të zhvillohen në kuadër të trajnimit fillestar.
2. Vlerësimi për prokurorët e shtetit në trajnim ka këtë përmbajtje:
 - 2.1 Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar;
 - 2.2 Kodi Penal;
 - 2.3 Kodi i Procedurës Penale;
 - 2.4 Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare;
 - 2.5 Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese;
3. Vlerësimi për gjyqtarët ka këtë përmbajtje:
 - 3.1 Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar;
 - 3.2 Kodi Penal;
 - 3.3 Kodi i Procedurës Penale;
 - 3.4 E Drejta Civile Materiale;
 - 3.5 Procedura Civile;
 - 3.6 Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare;
 - 3.7 Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese;
4. Vlerësimi i trajnimeve përmes platformës së mësimin në distancë do të bëhet bazuar në mundësitë teknike që ofron kjo platformë.
5. Gjyqtarët e caktuar në divizionin penal do të vlerësohen sipas paragrafit 3 pikat 3.1, 3.2, 3.3, 3.6 dhe 3.7, ndërsa gjyqtarët e caktuar në divizionin civil do të vlerësohen sipas paragrafit 3.1, 3.4, 3.5, 3.6 dhe 3.7 të këtij neni.

Neni 16

Hartimi i testeve vlerësuese

1. Hartimi i testeve vlerësues bëhet në kushte konfidenciale dhe hapësira të mbrojtura nga ndërhyrjet e jashtme.
2. Testi hartohet dhe vlerësohet nga trajnuesit e përzgjedhur nga Akademia, por jo nga mentorët.
3. Testimi mbahet pas përfundimit të secilit modul.

Neni 17
Administrimi i procesit të vlerësimit

1. Pjesëmarrësit informohen me kohë për ditën dhe vendin ku mbahet testimi, por jo më vonë se 3 ditë para mbajtjes së testimit.
2. Nëse ndonjë nga përfituesit për shkaqe të arsyeshme nuk paraqitet në ditën dhe kohën e testimit, Drejtori i Akademisë, mund të vendos që ata t'i nënshtrohen një ditë tjetër testimit.
3. Testimi organizohet në hapësira të cilat kanë kushte të favorshme për mbajtjen e testimit dhe fillon e përfundon në të njëjtën kohë për të gjithë përfituesit.
4. Në sallë ku mbahet testimi, përfitueseve ju lejohen të kenë me vete vetëm ligjet përkatëse të cilat sigurohen nga Akademia bazuar në strukturën e testimit.
5. Administrimi i testimit do të mbikëqyret nga Drejtori i Akademisë.
6. Në sallën e testimit, përfituesit duhet të ulen në rreshtin dhe vendin i cili u është caktuar nga mbikëqyrësi i sallës aty për aty. Përfitueseve të cilët vinë në testim pasi të mbyllet dera e sallës së testimit nuk do t'u lejohet hyrja në testim.
7. Kurrfarë çante, dosje, stilolapsa, lapsa, fletore, dokumente, telefona, pajisje teknologjike, dëgjuese/kufje apo pajisje tjetër elektronike të çfarëdo lloji nuk janë të lejuara në sallën e testimit. Këto pajisje merren dhe ruhen gjatë procesit të regjistrimit.
8. Shkelja e kësaj rregulle e zbuluar para shpërndarjes së pyetjeve të testimit do të rezultojë me marrjen e përkohshme të mjetit deri në përfundimin të testimit. Nëse shkelja do të zbulohet gjatë apo pasi të ketë përfunduar testimi, do të rezultojë me shpalljen e pavlefshme dhe vlerësim me zero pikë për atë pjesë të testimit.

Neni 18
Vlerësimi i testit

1. Vlerësimi i testit, bëhet në afat sa më të shpejtë të mundshëm, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga mbajtja e testit.
2. Vlerësimi bëhet nga trajnuesit e njëjtë që kanë hartuar testin.
3. Akademia paraprakisht harton kriteret për vlerësim, me qëllim që përfituesit të vlerësohen njëjtë.
4. Vlerësimi do bëhet në formë anonime dhe përshtatshmërisht me dispozitat e nenit 16 të kësaj rregullore.

Neni 19
Rezultatet e testit

1. Testimi për prokurorët e shtetit dhe gjyqtarët bëhet ndaras.
2. Për secilën pjesë të testimit për gjyqtarët e sapo emëruar renditja është si në vijim:
 - 2.1 Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar 10 pikë;
 - 2.2 Kodi Penal 20 pikë;
 - 2.3 Kodi i Procedurës Penale 20 pikë;
 - 2.4 E Drejta Civile Materiale 20 pikë;
 - 2.5 Procedura Civile 20 pikë;
 - 2.6 Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare 5 pikë;
 - 2.7 Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese 5 pikë.
3. Për secilën pjesë të testit për prokurorët e shtetit të sapo emëruar, renditja e pikëve është si në vijim:
 - 3.1 Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar 10 pikë;
 - 3.2 Kodi Penal 25 pikë;
 - 3.3 Kodi i Procedurës Penale 40 pikë;
 - 3.4 Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare 15 pikë;
 - 3.5 Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese 10 pikë;
4. Vlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit në trajnim do të bëhet sipas niveleve:
 - 4.1 Pamjaftueshëm konsiderohet 0-40 pikë;
 - 4.2 Mjaftueshëm konsiderohet 41-60 pikë;
 - 4.3 Mirë konsiderohet 61-80 pikë;
 - 4.4. Shumë mirë konsiderohet 81-100 pikë.

Neni 20 **Procedura e ankesave**

1. Përfituesit e trajnimit kanë të drejtë ankese për rezultatet e testimit në afat prej 3 ditësh nga dita e shpalljes së rezultateve.
2. Komisioni i ankesave përbëhet nga 5 anëtarë të cilët caktohen nga Këshilli Drejtues i Akademisë:
 - 2.1. dy gjyqtarë,
 - 2.2 dy prokurorë dhe
 - 2.3 një anëtar i Këshillit Drejtues

Neni 21 **Dispozitat përfundimtare**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet Rregullorja Nr. 01/2016 për Programin e Trajnimit Fillestar.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Akademisë.

Prishtinë, 01.06.2017



Aleksandër Lumezi

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Aneks II – Raport i trajnuesit për rezultatet e vlerësimit për përfundim të modulit trajnues

Emri dhe mbiemri i gjyqtarit/prokurorit të shtetit në PTF:				Moduli Trajnues:		
Identifikim i Fakteve	Njohja dhe zbatimi i ligjit	Analizimi i fakteve	Konkluzioni dhe arsyetimi	Gjuha e përdorur	Vlerësimi i përgjithshëm	
Pamjaftueshëm <input type="checkbox"/>	Pamjaftueshëm <input type="checkbox"/>	Pamjaftueshëm <input type="checkbox"/>	Pamjaftueshëm <input type="checkbox"/>	Pamjaftueshëm <input type="checkbox"/>	Pamjaftueshëm <input type="checkbox"/>	Pamjaftueshëm <input type="checkbox"/>
Mjaftueshëm <input type="checkbox"/>	Mjaftueshëm <input type="checkbox"/>	Mjaftueshëm <input type="checkbox"/>	Mjaftueshëm <input type="checkbox"/>	Mjaftueshëm <input type="checkbox"/>	Mjaftueshëm <input type="checkbox"/>	Mjaftueshëm <input type="checkbox"/>
Mirë <input type="checkbox"/>	Mirë <input type="checkbox"/>	Mirë <input type="checkbox"/>	Mirë <input type="checkbox"/>	Mirë <input type="checkbox"/>	Mirë <input type="checkbox"/>	Mirë <input type="checkbox"/>
Shumë mirë <input type="checkbox"/>	Shumë mirë <input type="checkbox"/>	Shumë mirë <input type="checkbox"/>	Shumë mirë <input type="checkbox"/>	Shumë mirë <input type="checkbox"/>	Shumë mirë <input type="checkbox"/>	Shumë mirë <input type="checkbox"/>
<p>Komenti i trajnuesit dhe rekomandimi për fusha(t) ku pjesëmarrësi ka nevojë për përmirësim dhe zhvillim të kompetencës/ ku nevojiten trajnime, nëse është e zbatueshme:</p>						

Data: ___ / ___ / ___

Emri & Nënshkrimi i Trajnuesit _____

Aneks III - Raporti i Mentorëve

	<u>Niveli</u>	
Aftësia për t'i identifikuar dhe përdorur rregullat e deontologjisë (Kompetenca “Integriteti personal dhe sjellja profesionale”)	E arritur	<input type="checkbox"/>
	Në progres	<input type="checkbox"/>
	E pa arritur	<input type="checkbox"/>
Aftësia për të analizuar dhe përshkruar një situatë apo rast (Kompetenca “Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore”)	E arritur	<input type="checkbox"/>
	Në progres	<input type="checkbox"/>
	E pa arritur	<input type="checkbox"/>
Aftësia për ti identifikuar, respektuar dhe garantuar rregullat ligjore (Kompetenca “Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore”)	E arritur	<input type="checkbox"/>
	Në progres	<input type="checkbox"/>
	E pa arritur	<input type="checkbox"/>
Aftësia për përshtatje dhe adaptim (Kompetenca “Ndërgjegjësimi social”)	E arritur	<input type="checkbox"/>
	Në progres	<input type="checkbox"/>
	E pa arritur	<input type="checkbox"/>
Aftësia për tu adaptuar dhe për të treguar autoritet në rrethana dhe situata specifike (Kompetenca “Ndërgjegjësimi social”)	E arritur	<input type="checkbox"/>
	Në progres	<input type="checkbox"/>
	E pa arritur	<input type="checkbox"/>
Aftësia për të pasur marrëdhënie të mirëfillta, dëgjim aktiv dhe shkëmbim informatash (Kompetenca “Ndërgjegjësimi social”)	E arritur	<input type="checkbox"/>
	Në progres	<input type="checkbox"/>
	E pa arritur	<input type="checkbox"/>
Aftësia për të monitoruar një audiencë në gjykatë, mirëpo me respekt ndaj palës kundërshtare (Kompetenca “Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore”)	E arritur	<input type="checkbox"/>
	Në progres	<input type="checkbox"/>
	E pa arritur	<input type="checkbox"/>
Aftësia për të gjetur zgjidhje dhe pajtuar palët (Kompetenca “Integriteti profesional dhe sjellja profesionale”)	E arritur	<input type="checkbox"/>
	Në progres	<input type="checkbox"/>
	E pa arritur	<input type="checkbox"/>
Aftësia për të marrë vendime të bazuara në drejtësi dhe fakte (Kompetenca “Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore”)	E arritur	<input type="checkbox"/>
	Në progres	<input type="checkbox"/>
	E pa arritur	<input type="checkbox"/>

Aftësia për motivim, formalizëm dhe shpjegim të vendimeve (Kompetenca “ Ndërgjegjësimi social ”)	E arritur <input type="checkbox"/> Në progres <input type="checkbox"/> E pa arritur <input type="checkbox"/>
Aftësia për të pasur parasysh rrethanat institucionale kombëtare dhe ndërkombëtare (Kompetenca “ Ndërgjegjësimi social ”)	E arritur <input type="checkbox"/> Në progres <input type="checkbox"/> E pa arritur <input type="checkbox"/>
Aftësia për të punuar në grup (Kompetenca “ Angazhimi profesional ”)	E arritur <input type="checkbox"/> Në progres <input type="checkbox"/> E pa arritur <input type="checkbox"/>
Aftësia për organizimin, menaxhimin dhe marrjen e iniciativave. (Kompetenca “ Angazhimi profesional ”)	E arritur <input type="checkbox"/> Në progres <input type="checkbox"/> E pa arritur <input type="checkbox"/>

Data: ____ / ____ / ____

Emri & Nënshkrimi i Mentorit: _____

Aneksi IV - Punimet hulumtuese

KRITERET PËR VLERËSIM	Vlerësimi (plotësisht, pjesërisht, aspak)
A. Niveli i parë	
Struktura dhe organizimi	
Gabimet në ligj	
Gabimet gramatikore	
Plagjjarizmi	
Koment:	
B. Niveli i dytë	
Identifikimi i fakteve	
Baza ligjore dhe burimet tjera	
Trajtimi i praktikës gjyqësor	
Koment:	
C. Niveli i tretë	
Relevanca	
Përfundimet e qarta	
Koment:	
Vlerësimi përfundimtar i Këshillit të Redaksisë për punim:	

Data: ____ / ____ / ____

Nënshkrimi i Këshillit të Redaksisë: _____